



RELACION

Data	
Nr. Prot	

VENDIMI

PËR

SHOYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. ARBIS ARIF VJERDHA, ANËTAR NË KËSHILLIN E BASHKISË SHKODËR, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR KOALICIONI A.S.E “PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE”, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Anëtari në Këshillin e Bashkisë”.

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Arbis Arif Vjerdha, anëtar në Këshillin e Bashkisë Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, më datë 13.5.2019, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. unik 4669. KQZ bëri verifikimin “prima facie” dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj me shkresën nr. V-1612/1 prot., datë 18.05.2019, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Arbis Arif Vjerdha, rezulton se nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë në sistem, rezulton i padënuar.
- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Arbis Arif Vjerdha, nuk ka ndryshime në gjeneralitete.

II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Arbis Arif Vjerdha.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Arbis Arif Vjerdha, rezulton se ka deklaruar:

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:

Pyetjes 2 ”A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar:

“Se është proceduar nga autoritetet e policisë në Shkodër”.

Pyetjes 3 “A keni qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar:

“Se është proceduar nga policia Italiane, Latina për kryerjen e veprës penale “Rrahje” në prill të vitit 2014”.

Pyetjes 4 “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO” duke deklaruar:

“Se është proceduar nga autoritetet e policisë në Shkodër shkurt të vitit 2018 për kryerjen e veprës penale “Rrahje”.

Pyetjes 5 “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO” duke deklaruar llojin e masës që i është caktuar nga Gjykata e Shkodrës,

“Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika

2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 14097 prot., datë 31.7.2019, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 31/27 prot.extra 21, datë 19.11.2024, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Arbis Arif Vjerdha. Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Arbis Arif Vjerdha, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë gjeneralitete të tjera përvec atyre të deklaruara në formular, por rubrika “amësia” rezulton të jetë e ndryshme në formular. Amësia e subjektit është “Bisera” dhe jo “Bisere”, siç është deklaruar nga subjekti;
- Aktualisht rezulton të jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë:

1. Me vendimin penal Nr. 241, datë 20.06.20219, i Gjykatës së Apelit Shkodër, i cili ka lënë në fuqi Vendimin Nr. 1035(2703), datë 30.05.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër që ka dekluar fajtor dhe dënuar të pandehurin Arbis Arif Vjerdha, për kryerjen e veprës penale “Fallsifikimi i vulave stampave apo formularëve”, parashikuar nga neni 190/1 i Kodit penal dhe dënuar me 9 (nëntë) muaj burgim. Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, i ulet 1/3 e dënimit duke e dënuar përfundimisht me 6 (gjashtë) muaj burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burg, duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe prej 12 (dymbëdhjetë) muaj me kusht. Kundër këtij vendimi subjekti Arbis Arif Vjerdha, ka ushtruar Rekurs pranë Gjykatës së Lartë. Çështja në Gjykatën e Lartë, ende nuk është shqyrtuar.

2. Gjykata Kolegjiale e Latinës, datë 03.07.2019, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Romë më datë 07.12.2022, dhe shpallur e pa pranueshme si ankesë nga Gjykata e Kasacionit të Romës, datë 07.12.2022, me të cilin subjekti Arbis Arif Vjerdha, është deklaruar fajtor dhe dënuar me 2 vite, 1 muaj dhe 13 ditë burgim, pezulluar ekzekutimi i vendimit me kusht, për lëndim personi, kryer në bashkëpunim në rrethana rënduese, parashikuar nga nenet 110, 582 të Kodit Penal.

- Rezulton të jetë i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar: Vendimin nr. 1985(54777) datë 12.12.2023 sipas të cilit Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit Arbis Arif Vjerdha, akuzuar për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, është pezulluar ekzekutimi i vendimit me burgim për një periudhë 12 muaj. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim i pandehuri Arbis Arif Vjerdha dhe çështja është dërguar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të

Përgjithshëm me nr. 1020 akti, datë 12.03.2024, me palë të pandehur Arbis Arif Vjerdha. Deri më datë 01.11.2024, kjo çështje nuk është planifikuar për gjykim.

- Rezulton të ketë qënë në hetim dhe gjykim nga autoritetet italiane të drejtësisë, proceduar nga policia italiane në vitin 2014, për veprën penale të “Lëndim personal” parashikuar nga nenet 110, 582, të Kodit Penal, duke u dënuar përfundimisht me vendim përfundimtar të formës së prerë, për dy vite 1 muaj e 13 ditë burgim, pezulluar ekzekutimi i dënimit me kusht.
- Rezulton të jetë arrestuar më datë 13.03.2018, deri më datë 16.03.2018, nga Strukturat e Komisarariatit të Policisë Shkodër, për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të rendit publik”.
- Rezulton që ndaj tij të jetë caktuar masë shtrënguese e sigurisë personale “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” me vendimin penal nr. 263(1238), datë 16.03.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndonjëherë ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale;
- Nuk rezulton të jetë marrë ndonjëherë ndaj tij masa e dëbimit nga një shtet i huaj;
- Nuk rezulton të ketë indicie/ të dhëna /rrethana/ fakte të bëra publike apo informacion për:
 - për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - për hetim ose gjykim nga një autoritet tjetër i huaj;
 - dënime të dhëna nga autoritete gjyqësore të tjera të huaja;
 - urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale;
 - marrjen e ndonjë mase dëbimi ndaj tij

II.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

Ligji nr. 138/2015 dhe vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjenrealitetet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime arrestime, hetime, etj).

Z. Arbis Arif Vjerdha, anëtar në këshillin e bashkisë Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019, i ka përfunduar mandati i anëtarit të këshillit bashkiak dhe për rrjedhojë nuk është subjekt i këtij ligji. Komisioneri nuk mund të shprehet me vendimmarrje për çështjen objekt shqyrtimi, për sa kohë ky subjekt nuk ka mandat, dhe në asnjë rast e për asnjë rrethanë nuk do të mund të marrë këtë funksion publik për të cilin është iniciuar procedura administrative e verifikimit të thelluar. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur përmbushen kushtet ligjore të moskandidimit, moszgjedhshmërisë, apo mbarimit të mandatit për rastet e parashikuara në ligjin 138/2015. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të nenit 11 të ligjit 138/2015, si dhe neneve 90 dhe 95 të ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave

Administrative” vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve.

Licela VELIU - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Pavlina DOÇAJ - Drejtorja e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA - Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data:

Nr:

Ora:

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. ARBIS ARIF VJERDHA, ANËTAR NË KËSHILLIN E BASHKISË SHKODËR, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR KOALICIONI A.S.E “PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE”, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Sot më datë .01.2025, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Arbis Arif Vjerdha, anëtar në Këshillin e Bashkisë Shkodër, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni ASE “Partia Demokracia Sociale”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Palë të interesuara: Z. Arbis Arif Vjerdha, anëtar në Këshillin e Bashkisë Shkodër, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni ASE “Partia Demokracia Sociale”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

Data: 00.00.2025 Nr:00
Ora: 00:00



“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Arbis Arif Vjerdha, anëtar në Këshillin e Bashkisë Shkodër, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni ASE “Partia Demokracia Sociale” për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019”

VËREJ:

I.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Anëtari në Këshillin e Bashkisë”.

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Arbis Arif Vjerdha, anëtar në Këshillin e Bashkisë Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, më datë 13.5.2019, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. unik 4669. KQZ bëri verifikimin “prima facie” dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj me shkresën nr. V-1612/1 prot., datë 18.05.2019, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Arbis Arif Vjerdha, rezulton se nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë në sistem, rezulton i padënuar.
- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Arbis Arif Vjerdha, nuk ka ndryshime në gjeneralitete.

II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Arbis Arif Vjerdha.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Arbis Arif Vjerdha, rezulton se ka deklaruar:

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:

Pyetjes 2 ”A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar:

“Se është proceduar nga autoritetet e policisë në Shkodër”.

Pyetjes 3 “A keni qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar:

“Se është proceduar nga policia Italiane, Latina për kryerjen e veprës penale “Rrahje” në prill të vitit 2014”.

Pyetjes 4 “A keni qënë ndonjëhere i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një veprë penale?, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO” duke deklaruar:

“Se është proceduar nga autoritetet e policisë në Shkodër shkurt të vitit 2018, për kryerjen e veprës penale “Rrahje”.

Pyetjes 5 “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO” duke deklaruar llojin e masës që i është caktuar nga Gjykata e Shkodrës,

“Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 14097 prot., datë 31.7.2019, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 31/27 prot.extra 21, datë 19.11.2024, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Arbis Arif Vjerdha. Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit të verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Arbis Arif Vjerdha, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë gjeneralitete të tjera përveç atyre të deklaruara në formular, por rubrika “amësia” rezulton të jetë e ndryshme në formular. Amësia e subjektit është “Bisera” dhe jo “Bisere”, siç është deklaruar nga subjekti;
- Aktualisht rezulton të jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë:

1. Me vendimin penal Nr. 241, datë 20.06.20219, i Gjykatës së Apelit Shkodër, i cili ka lënë në fuqi Vendimin Nr. 1035(2703), datë 30.05.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër që ka deklaruar fajtor dhe dënuar të pandehurin Arbis Arif Vjerdha, për kryerjen e veprës penale “Fallsifikimi i vulave stampave apo formularëve”, parashikuar nga neni 190/1 i Kodit penal dhe dënuar me 9 (nëntë) muaj burgim. Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, i ulet 1/3 e dënimit duke e dënuar përfundimisht me 6 (gjashhtë) muaj burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burg, duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe prej 12 (dymbëdhjetë) muaj me kusht. Kundër këtij vendimi subjekti Arbis Arif Vjerdha, ka ushtruar Rekurs pranë Gjykatës së Lartë. Çështja në Gjykatën e Lartë, ende nuk është shqyrtuar.

2. Gjykata Kolegjiale e Latinës, datë 03.07.2019, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Romë më datë 07.12.2022, dhe shpallur e pa pranueshme si ankesë nga Gjykata e Kasacionit të Romës, datë 07.12.2022, me të cilin subjekti Arbis Arif Vjerdha, është deklaruar fajtor dhe dënuar me 2 vite, 1 muaj dhe 13 ditë burgim, pezulluar ekzekutimi i vendimit me kusht, për lëndim personi, kryer në bashkëpunim në rrethana rënduese, parashikuar nga nenet 110, 582 të Kodit Penal.

- Rezulton të jetë i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar: Vendimin nr. 1985(54777) datë 12.12.2023 sipas të cilit Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit Arbis Arif Vjerdha, akuzuar për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, është pezulluar ekzekutimi i vendimit me burgim për një periudhë 12 muaj. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim i pandehuri Arbis Arif Vjerdha dhe çështja është dërguar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 1020 akti, datë 12.03.2024, me palë të pandehur Arbis Arif Vjerdha. Deri më datë 01.11.2024, kjo çështje nuk është planifikuar për gjykim.
- Rezulton të ketë qënë në hetim dhe gjykim nga autoritetet italiane të drejtësisë, proceduar nga policia italiane në vitin 2014, për veprën penale të “Lëndim personal” parashikuar nga nenet 110, 582, të Kodit Penal, duke u dënuar përfundimisht me vendim përfundimtar të formës së prerë, për dy vite 1 muaj e 13 ditë burgim, pezulluar ekzekutimi i dënimit me kusht.
- Rezulton të jetë arrestuar më datë 13.03.2018, deri më datë 16.03.2018, nga Strukturat e Komisarariatit të Policisë Shkodër, për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të rendit publik”.
- Rezulton që ndaj tij të jetë caktuar masë shtrënguese e sigurisë personale “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” me vendimin penal nr. 263(1238), datë 16.03.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndonjëherë ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale;
- Nuk rezulton të jetë marrë ndonjëherë ndaj tij masa e dëbimit nga një shtet i huaj;
- Nuk rezulton të ketë indicie/ të dhëna /rrethana/ fakte të bëra publike apo informacion për:
 - për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - për hetim ose gjykim nga një autoritet tjetër i huaj;
 - dënime të dhëna nga autoritete gjyqësore të tjera të huaja;
 - urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale;
 - marrjen e ndonjë mase dëbimi ndaj tij

II.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

Ligji nr. 138/2015 dhe vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjenrealitetet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime arrestime, hetime, etj).

Z. Arbis Arif Vjerdha, anëtar në këshillin e bashkisë Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019, i ka përfunduar mandati i anëtarit të këshillit bashkiak dhe për rrjedhojë nuk është subjekt i këtij ligji. Komisioneri nuk mund të shprehet me vendimmarrje për çështjen objekt shqyrtimi, për sa kohë ky subjekt nuk ka mandat, dhe në asnjë rast e për asnjë rrethanë nuk do të mund të marrë këtë funksion publik për të cilin është iniciuar

procedura administrative e verifikimit të thelluar. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur përmbushen kushtet ligjore të moskandidimit, moszgjedhshmërisë, apo mbarimit të mandatit për rastet e parashikuara në ligjin 138/2015. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të nenit 11 të ligjit 138/2015, si dhe neneve 90 dhe 95 të ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Deklarimin e procedurës administrative të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues z. Arbis Arif Vjerdha, anëtar në këshillin e bashkisë Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI